



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:132838

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05606718

P.nr 685/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjyquese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësore Šejla Ćorović në çështjen penale kundër të pandehuri A.L nga Peja, D , rr.,R. H” nr..., për shkak se ka kryer veprë penale „Kanosja” nga neni 181 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr1429/20 të datës 12.10.2020, në bazë të nenit 229 par.5, 357 të KPPRK-së dhe nenit 12 dhe 15 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, jashtë shqyrtimit, me datë 03.04.2024, bie këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim me shenjën ND.nr.366/24 e lidhur me datë 20.03.2024 në mes të pandehurit (pala B) A.L nga Peja, D , rr.,R. H” nr..., me numër personal, dhe të dëmtuarës (pala A) F.Z rr. „B.R M”, komuna Pejë, me numër personal

II. HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr1429/20 të datës 12.10.2020.

III. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit A.L nga Peja, D , rr.,R. H” nr.15, me numër personal, për shkak se ka kryer veprë penale „Kanosja” nga neni 181 par.1 të KPRK-së, për arsye se i pandehuri dhe e dëmtuara, kanë arritur marrëveshje për ndërmjetësim.

IV. Shpenzimet e procedurës penale i bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Arsy e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzë nën shenjën PP/II.nr1429/20 të datës 12.10.2020, ndaj të pandehurit A. L nga Peja, D., rr.,„R.H” nr..., me numër personal, për shkak se ka kryer vepër penale „Kanosja” nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale, kjo gjykatë me datë 20.03.2024, ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, në të cilën seancë, me kërkesën e te dëmtuarit që kjo çështja penale te referohet në procedurën e ndërmjetësimit gjykata merr pëlqimin e të pandehurit dhe të Prokurorit të Shtetit, me ç ‘rast palët janë deklaruar se pajtohen që çështja penale të referohet në procedurën e ndërmjetësimit, me qëllim të arritjes së marrëveshjes 8eventuale.

Pas pëlqimit të palëve për zgjidhjen e kësaj çështje penale në procedurën e ndërmjetësimit, gjyqtarja e çështjes e ka ndërprerë seancën dhe me datë 20.03.2024, ka marr vendimin për ta dërguar lëndën pranë koordinatorit për ndërmjetësim të kësaj gjykate që të procedoj lëndën në procedurë të ndërmjetësimit.

Me datë 20.03.2024, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Pejë, është lidhur marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar nga ndërmjetësuesi Zymer Metaj, ndërmjet të pandehurit (pala B) A. L nga Peja, D., rr.,„R.H” nr..., me numër personal,

Sipas marrëveshjes së arritur ndërmjet të pandehurit dhe të dëmtuarës palët kanë deklaruar se marrëveshjen e lidhin në vullnet të plotë dhe pa shtytje nga askush. Njëkohësisht të pandehuri i shpreh keqardhje për rastin e ndodhur dhe njëkohësisht i kërkon falje të dëmtuarit-ës me ç ‘rast e dëmtuara e pranojnë kërkim faljen nga të pandehuri. E dëmtuara po ashtu nuk kërkon kompensim demi.

Palët pa ndonjë kërcënim dhe me vet dëshirë kanë shprehur gatishmëri që kjo çështje të zgjidhet me marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit dhe nuk i kontestojnë asnjë nga pikat e lartpërmendura.

Qendra e Ndërmjetësimit me datë 20.03.2024, me numër të lëndës në ndërmjetësim Nd.nr.366/24 ka lidhur marrëveshjen e palëve të lartpërmendura për zgjidhjen e ndërmjetësuar.

Andaj, gjykata duke vepruar sipas dispozitave të nenit nenit 229 paragrafi 5 të KPPRK-së dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, e aprovoi këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve dhe është në pajtim me dispozitat e KPPRK-së dhe me Ligjin për Ndërmjetësim, ku kjo marrëveshje do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPPRK-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lartë dhe në bazë të nenit 229 par.5 , 357 par.1 nën par. 1.3, nenit 453 të KPPRK-së dhe nenit 12 dhe 15 par.1 të Ligjit për ndërmjetësim, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti I Përgjithshëm
Divizioni Penal
P.nr685/20, me datë 03.04.2024

Praktikante gjyqsore

Šejla Ćorović

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Ilda Cucović Sahatçiu

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese,
në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimt të këtij aktvendimi,
pranë Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.